



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 1380 Më 26.04.2019
Br. prot. Dt. 26.04.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI 3 MUJOR I PUNËS

JANAR, SHKURT DHE MARS 2019



2019

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë 3 MUJORIT të parë të vitit 2019

- Sipas planit të prokurimit të dorëzuar në (Dhjetor 2018), DSHP ka filluar të respektojë datat e dhëna në planifikim, ka përgatit gjatë muajit janar, dy projekte,
 - a). Projektin për furnizim me gypa nga PVC dhe,
 - b). Projektin për intervenime emergjente,
- Është mbajtur takimi i tretë me radhë i komisionit komunal për stacionin e autobusëve dhe në këtë peirudhë, u mor vendim për shpalljen e konkursit për bordin e këtij stacioni, pas konkursit është formuar bordi prej katër anëtareve si dhe është shpall konkursi për kryeshef ekzekutiv,
- Gjatë muajit janar është mbajtur debati i dyte publik, me ekspert të komunës nga fusha të ndryshme që kane njohuri rreth projektit te autostradës, pikërisht tema e këtij debati ka qenë autostrada e dukagjinit,
- Pas reshjeve të mëdha të dëborës në të gjithë territorin e komunës sonë, kemi pasur angazhime me dy kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, që vazhdimisht ishim në dispozicion të plotë në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore,
- Kemi caktuar zyrtarin për eficientë që do të kujdeset më shumë me grupin punues të komunës, së bashku me organizatën GIZ, të marrin informata të mjaftueshme në teren, në mënyrë që të dalim me raporte të sakta për gjendjen e objekteve institucionale në komunën tonë,
- Kemi mbajtur vazhdimisht takime me zyrtare të MKRS të kësaj ministrie për çështjen e palestrës sportive në Rahovec, ku me 27 shkurt 2019 është bërë hapja solemne,
- Janë përgatit dy detyra projektuese, projekti për parkingjet e reja në qytet, ku drejtoria shume shpejt do të mbaj një debat publik për çështjen e parkingjeve në rrugët kryesore të qytetit, si dhe detyra tjetër projektuese ka të bëjë me semaforët e rinjë në qytet, këto dy projekte mund të shpallen në momentin që kemi kontrate për hartimin e projekteve,
- Me 21 janar kam mbajtur takim me organizatën UNDP në një takim të përbashkët në drejtori, është kerkuar mbështetje në disa projekte në kuadër të mbrojtjes së mjedisit si dhe forma e pranim dorëzimit te impiantit ne Kramavik në kuadër te kompanisë KRU Gjakova,
- Kanë përfunduar punimet në projektin ndërtimi i trotuareve në Drenoc, në Malesi të Vogël si dhe është duke vazhduar projekti në fshatin Sapniq,
- Ka filluar puna në ndërtimin e disa rrugëve në qytet dhe fshatra, punimet kanë përfunduar në fshatin Polluzhë, Pastasel, në rrugën "Tafil Zymberi" në Rahovec dhe në rrugën e Zaqishtit janë duke vazhduar punimet,
- Është bërë një ndërhyrje emergjente në rrugën Fortesë-Celine, në sanimin e gropës së krijuar në rrugë,
- Janë dërguar kërkesa zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës për projektet ne vazhdim, për shkak se është kërkuar të ndahet buxheti i Ministrisë për marrëveshjet që i kemi si komunë, në projektet e trashëguara nga viti 2018,
- Gjate kësaj periudhe është bërë traseja e re e rrugës për deponi inerte, pas pëlqimit të marrur nga kompania Stone Castle për të kaluar në pjesën e rrugës nga vreshtat,

RAPORTI 3 MUJOR I PUNËS

- Në mbledhjet e mbajtur të kuvendit të komunës si drejtori kemi pasur dy pika, një për themelimin e komitetit konsultativ për shërbime publike si dhe vendimin për interes të përgjithshëm të pronës ku kalon traseja e rrugës transite,
- Pas punimeve intensive të ndërtimit të palestrës sportive në Rahovec, me 27 shkurt është bërë përfundimi i pjesshëm i palestrës,
- Janë bërë marrëveshjet e bashkëfinancimit nga Ministria e Infrastrukturës me komunën e Rahovecit për të investuar në disa projekte që kapin shifrën mbi 1.5 milion €.
 1. Ndërtimi i rrugës Rahovec- Hamoc- Fortesë,
 2. Ndërtimi i rrugës Xërxë-Sapniq-Ratkoc,
- Janë përfunduar një mori segmente rrugore të ndricimi publik, si: segmenti prej 2 km i ndricimit publik në Xërxë, janë përfunduar 3 rrugë kryesore të ndricimit publik të lagjeve në qytet, segmenti i rrugës kryesore në Ratkoc në gjatësi prej 1.4 km, ndricimi publik në varrezat e fshatit Hoqë e Vogël, vazhdojnë punimet në Dejn,
- Kanë filluar të trajtohen disa rrugë që janë me prioritet të lartë si në qytet, edhe në fshatrat e komunës sonë, kemi filluar me ndërtimin e rrugës në Pastasel, Polluzhë, Xërxë, Rahovec, Zoqisht e në shumë vende tjera.
- Ka filluar projekti i trajtimit të kanalizimit në komunën tonë dhe deri më tani llogaritet projekti më i madh i trajtimit të ujërave fekale, që prin me qytetin e Rahovecit, pastaj edhe në 16 vendbanime tjera, janë rehabilituar disa degëzime të kanalizimeve në Ratkoc, është përfunduar një lagje në Celinë, vazhdon projekti sipas prioriteteve edhe në vendbanime të tjera.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2019 do të jenë:

- Kërkesa të mëdha për rrjete të reja të kanalizimit, ndërtimit të rrugëve lokale dhe për të përfunduar rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara, ka me qindra kërkesa që po adresohen në drejtori, por mundësitë buxhetore janë të limituara dhe si drejtori kemi pak mundësi për realizimin e tyre,
- Mirëmbajtja e përroskave dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane, edhe pse kontrata është e lidhur për intervenime emergjente,
- Kërkesa të vazhdueshme për ndricim publik,
- Kërkesa të vazhdueshme për ndërtim të trotuareve,
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka percjellur gjatë vitit 2018 janë mbeturinat e amviserise që fatkeqsisht hidhen kudo, vend dhe pa vend ku krijohen deponie ilegale,
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e KRU Gjakovës.

Drejtori i DSHP-së

Përparim Krasniqi